

## **AKT THEMELIMI**

### **I SHOQËRISË TREGTARE “ RELIVE IT RELOVE IT GROUP ” SH.P.K ME SELI NË TIRANË**

\*\*\*\*\*

Sot, më datë 18/03/2022, në Tiranë,

**Znj.Albiona Xhaferaj** shtetase shqiptare e lindur më 21.01.1999 në Tepelene, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.J95121017P.

**Znj.Jeta Xhaferaj** shtetase shqiptare e lindur më 13.03.2000 ne Permet , Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me Pashaporte me Nr.K05313018E.

Të cilët kanë vendosur themelimin e shoqërisë “**RELIVE IT RELOVE IT GROUP ” SH.P.K** shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

#### **NENI 1**

Shoqëria “ **RELIVE IT RELOVE IT GROUP ” SH.P.K** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria është Person Juridik Privat Italian. Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendos ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

#### **NENI 2**

##### **Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin “ **RELIVE IT RELOVE IT GROUP ” SH.P.K**

#### **NENI 3**

##### **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka për objekt - në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

Startup ne fushen e prodhimeve te xhinseve dhe veshjeve , aksesoreve te tyre nepermjet brand-it RELIVE IT RELOVE IT, duke perdorur materiale te ricikluara.

Shitjen e produkteve RELIVE IT RELOVE IT, nepermjet dyqaneve online dhe shperndarjes me poste.

Menaxhim i brand-it RELIVE IT RELOVE IT dhe te drejtave te pronesise intelektuale qe burojne nga krijimtaria e brand-it.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Abdyl Frasheri, Nr.7 , Kati 1, 1000, Tirane, Shqiperi.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 2.kuota.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

**Znj.Albiona Xhaferaj** 1 kuotë, me vlerë 50 Lekë, zotëron 50%

**Znj.Jeta Xhaferaj** 1 kuotë, me vlerë 50 Lekë, zotëron 50 %

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori .

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë : **Znj.Albiona Xhaferaj** shtetase shqiptare e lindur më 21.01.1999 në Tepelene, Shqiperi, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me kartë identiteti Nr.J95121017P.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

#### **NENI 8**

### **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

### **NENI 9**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmbtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

### **NENI 10**

#### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

### **NENI 11**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**


Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

### **NENI 12**

#### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

### **ORTAKËT THEMELUES**

Albioma Xhaferaj  


Jeta Xhaferaj  
